

01-1676



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-222387/22 dt. 14.10.2022 dhe 05 Nr. 391/02-222387/22/1 dt. 14.10.2022, të aplikuesi/pronarit Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shëndetësore, “Depo qendrore e vaksinave COVID 19”, me etazhitet P+0, ndërtuar në kuadër të Kompleksit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës – QKUK-së, pjesës së parcelës ndërtimore “A1/1-1” të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, në rr. “Aleksandër Fleming”, numër 15, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 26.10.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Ministrisë së Shëndetësisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-222387/22 dt. 14.10.2022 dhe 05 Nr. 391/02-222387/22/1 dt. 14.10.2022, përdorimi i ndërtesës shëndetësore, “Depo qendrore e vaksinave COVID 19”, me etazhitet P+0, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr.351/02-135218/21 dt. 27.08.2021, në parcelën kadastrale nr. 2805-9 ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “A1/1-1”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Aleksandër Fleming” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 15, në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj certifikate të përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e kësaj certifikate të përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Aplikuesi/pronari Ministria e Shëndetësisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-199453/22 dt. 18.08.2022 dhe 05 Nr. 391/02-222387/22/1 dt. 14.10.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shëndetësore, “Depo qendrore e vaksinave COVID 19”, me etazhitet P+0, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “A1/1-1”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 2805-9 ZK Prishtinë, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr.351/02-135218/21 dt.27.08.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 05 Nr. 351-02-186587/22 dt. 26.08.2022, ka përcjellë

Faqe 1 prej 2

në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Fidan Belegu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi, Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Fatos Gashi me nr. të licensës 188;

Drejtoria e Urbanizimit, pas pranimit të kërkesës 05 Nr. 392-245871 dt. 23.12.2013 dhe 05 Nr. 391/02-222387/22/1 dt. 14.10.2022, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, shqyrtimit të përmbajtjes së tyre dhe të dokumentacionit të prezantuar me kërkesa dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës administrative, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, duke u mbështet në paragrafin 1. të nenit 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se, citojmë: *“Organi publik kompetent mund të bashkoj disa procedura administrative në një të vetme nëse të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë apo të ngjajshme”*, vendosi ti bashkojë dhe ti trajtojë në një procedurë të vetme administrative, gjegjësisht ti trajtojë me një vendim, duke u bazuar edhe në faktin se kërkesat janë parashtruar nga të njëjtit aplikues, dhe kanë të bëjnë me të njëjtën çështje. Pas këtij konstatimi dhe veprimi administrativ, kjo drejtori mori në shqyrtim kërkesat e lartcekura, dokumentacionet e bashkëngjitura me kërkesa dhe atë gjatë fazës së zhvillimit të procedurës administrative, konkretisht të Raportit të Inspektimit Final, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, si dhe të dokumentacionit tjetër të dorëzuar nga investitori, në mënyrë kronologjike dhe procedurale, konstaton si në vijim:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shëndetësore mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shëndetësore.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj

Certifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit të shtetit dhe Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.



DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-222387/22 DT. 26.10.2022

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi
N. Krasniqi

Drejtori,
Arber Sadiki
A. Sadiki



